

Nr: 10-96  
Shkup: 14.10.2022

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) i Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), dhe në bazë të Kërkesës për mendim të pranuar nga Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale nr. 13-912/1 të datës 14.06.2022 (Numri ynë 10-96 i datës 15.06.2022), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 14.10.2022, solli

### MENDIM

Drejtorja e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale i dorëzoi Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës kërkesë për mendim nr. 13-912/1 të datës 14.06.2022 (Nr .ynë 10-96 të datës 15.06.2022) në lidhje me ndryshimet shtesë të bëra në Propozim Aneks Marrëveshjen për dhënien e ndihmës shtetërore të datës 29.01.2019 për KOSTAL MAKEDONIA SHPKNJ Ohër si përfituese të ndihmës shtetërore dhe për të cilin Propozim Aneks Marrëveshje, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka dorëzuar mendim me nr. 10-113 datë 03.11.2021, në Drejtorinë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale.

Duke pasur parasysh se, se Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kishte nevojë për sqarime shtesë dhe korigjim të ndryshimeve shtesë të bëra në Propozim Aneksin e Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore KOSTAL MAKEDONIA SHPKNJ Ohër si përfituese e ndihmës shtetërore, takimi është mbajtur më 20.06. 2022 në ambientet e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, ku morën pjesë përfaqësues i punonjësve nga Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale dhe përfaqësues të punonjësve nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Drejtorja për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale me shkresën nr. 13-912/3 të datës 06.09.2022, ka dorëzuar tekstin e ndryshuar të Propozimit Aneks Marrëveshjes nr. 1 të Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore për KOSTAL MAKEDONIA SHPKNJ Ohër.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës e shqyrtoi tekstin e ndryshuar të Propozimit Aneks Marrëveshjes nr. 1.

Në nenin 9 të tekstit të ndryshuar të Propozimit Aneks Marrëveshjes nr. 1, thuhet se nenit 6 të Marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore i shtohet një paragraf i ri 6.4. Në këtë paragraf thuhet se dhënësi i ndihmës shtetërore do t'i paguajë ndihmë shtesë përfituesit të ndihmës shtetërore, e cila do të llogaritet në masën 45% të shumës së ndihmës së përcaktuar në nenet 5, 6 dhe 7 të kësaj Marrëveshjeje për këstet e planifikuara në periudhën nga data 01.01.2022 deri më 30.06.2026, ku do t'i paguhet përfituesit të ndihmës shtetërore jo më vonë se fundi i vitit kalendarik për të cilin është planifikuar kësti. Për të shmangur dyshimin, ndihma totale sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë e vlefshme deri në datën në të cilën ndihma arrin kufirin maksimal të intensitetit të nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje.

Për pjesën tjetër të neneve nga teksti i ndryshuar i Propozimit të Aneks Marrëveshjes nr. 1, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka dorëzuar mendim me nr. 10-113 të datës 03.11.2021 në Drejtorinë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale.

Lidhur me ndryshimin e nenit 9 të tekstit të ndryshuar të Propozimit të Aneks Marrëveshjes nr. 1, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës **vlerëson se nuk ka nevojë për njoftim shtesë.**

Në përputhje me nenin 3 paragrafi (3) të Dekretit për mënyrën dhe procedurën për parashtrimin e njoftimit për dhënie e ndihmës shtetërore si dhe procedurën për mbikëqyrjen e ndihmës ekzistuese shtetërore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 142/11) njoftimi për ndryshimin e ndihmës shtetërore ekzistuese, i dorëzohet Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nëse ka një rritje mbi 20% të buxhetit të skemës së ndihmës së përhershme, dhënia e së cilës është lejuar më parë nga Komisioni.

Duke marrë parasysh kornizën ligjore të lartpërmendur, dhënësi i ndihmës shtetërore nuk ka nevojë për njoftim shtesë në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për rritjen e planifikuar të investimeve për KOSTAL MAKEDONIA SHPKNJP Ohër.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në përputhje me nenin 24 të Ligjit për kontrollin e ndihmës Shtetërore, mbikëqyr ndihmën shtetërore të lejuar të dhënë në vitin e kaluar, në bazë të një raporti vjetor që çdo dhënës i ndihmës shtetërore është i detyruar t'i dorëzojë Komisionit më së voni deri më 1 mars të vitit aktual.

**KRYETAR**

**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**Prof. Dr. Владимир Наумовски**